

GUIDE ORIENTUESE MBI GURET KILOMETRIK TE KOMUNIKIMIT

0-36 M



PERSHTATI: INA XHAFI

BURIMI: SPEECHSISTERS

Pershendetje

FALEMINDERIT QE KE ZGJEDHUR TE LEXOSH KETE GUIDE ORIENTUESE

Une jam Ina Xhafa, me formim psikologe dhe studiuese politikash edukimi. Jam gjithashtu autore e blogut The Mom Corner .al (ne instagram dhe web themom-corner.al).

Se pari dua te sqaroj se kjo guide nuk eshte e punuar nga une por nga SpeechSisters.com. Une kam bere perkthimin dhe adaptimin ne kete format qe ju po e merrni.

Nje blog nga dy motra me mbi 20 vite eksperience si terapistes gjuhesore ne Amerike. Me pelqyen detajet e trajtuara ketu, keshtu vendosa ta ndaj si material dhe me ju ne shqip. Por nuk rezervoj te drejta autori :). Shpresoj t'ju vije ne ndihme!

Perqafime

Ina Xhafa



Dy format e komunikimit

1. Gjuha e Kuptuar

2. Gjuha e Shprehur

GJUHA E KUPTUAR

Gjuha e kuptuar apo shqip shqip te kuptuarit eshte aftesia e femijes per te kuptuar ate cka i thuhet. Procesimi i asaj qe degjon dhe te kuptuarit jane pjese e zhvillimit gjuhesor



GJUHA E SHPREHUR

Aftesia per te verbalizuar nevojat dhe deshirat qe femija ka. Akti i nxjerrjes se tingujve ne forme fjalesh/ me kuptim dhe qellim per tu shprehur

ZHVILLIMI GJUHESOR

ARRITJET E MEPOSHTME JANE NE BAZA TE GUREVE KILOMETRIK TE ZHVILLIMIT, QE DO TE THOTE JANE TE VENDOSURA PER 90% TE FEMIJEVE. PRA 90% E FEMIJEVE I KANE KETO ARRITJE NE BAZE TE MOSHES PERKATESE. MESATARJA (50%) MUND TI ARRIJNE SHUME ME SHPEJT

3-6 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- Shikon fytyren e nje personi kur ai eshte duke folur
- Kthen koken ne drejtim te tingujve
- Njeh objektet e perditshmerise (krevatin, shishen,

GJUHA E SHPREHUR

- Ben "uu"(tinguj bebi)
- Buzeqesh si pergjigje ndaj buzeqeshjes/zerit
- Perpiqet te imitoje tinguj/mimika fytyre
- Qesh me ze
- "Kthen pergjigje"kur i flasin duke leshuar tinguj

6-9 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- Fillon te kuptoje fjale dhe e shpreh me veshtirm
- Kupton gjeste
- Shikon objekte/persona/figurat kur i thuhet emri
- Pergjigjet ndaj "jo"

GJUHA E SHPREHUR

- I pelqejne nderveprimet sociale me njerezit qe i njeh
- Luan ne forme vokale (leshon tinguj)
- "Flet"(gjuhe bebi) (tingujt: p, b, m, n, t, d, y)
- Perpiqet te imitoje gjeste
- Perpiqet te nxjerre tinguj si fjale



ZHVILLIMI GJUHESOR

9-12 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- I pergjigjet/reagon ndaj "hajde ketu"
- Kerkon per objekte te fshehura
- Kupton komanda te thjeshta te shoqeruara me gjeste
- Shikon fotot e duhura ne liber kur i thuhet emri objektit
- I pergjigjet emrit te tij/saj
- Ndjek komanda te thjeshta me trupin "bej bravo, bej pacim"
- E jep nje objekt kur i kerkohet
- I pergjigjet pyetjeve te thjeshta duke kerkuar psh. shikon verdall kur i thuhet "Ku eshte babi?"

GJUHA E SHPREHUR Afer 12 muajsh thote pak fjale

- Perpiqet ti imitoje fjalet e ti perserise tingujt
- Perdoret gjestet e thjeshta si "bravo" "jo"
- Pergjigjet kur i flet duke prodhuar grupe tingujsh
- I pelqejne lojerat si "Ta" dhe te degjoje muzike
- Leshon tinguj me intonacione te ndryshme
- Thote fjalet e para (Baba/mama)
- Shikon drejt nje objekti nese e do ate
- Imiton lojen funksionale (shtyn makinen psh)
- Bertet ose ben sikur kollitet per te marre vemendjen
- Tregon me gisht apo zgjatet per te marre cfare do
- Ben 'Pacim'



ZHVILLIMI GJUHESOR

12-18 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- Realizon komanda teke si "merre topin"
- Tregon objektet qe do/njeh
- Identifikon 1-3 pjese trupi
- Identifikon 2 apo me shume objekte ne nje liber
- Demonstron lojen funksionale (perdor me shume se nje loder)
- Kopjon loje imagjinare te thjesht "jepi lopes te haje"
- Ndjek komanda verbale teke pa shoqerim gjesti (psh. ulu)

GJUHA E SHPREHUR

- Imiton nje fjale (jo domosdoshmerisht ne forme te paster)
- Perdor intonacion si ne fjali
- Leshon tingujt bashke me gjestet
- U pergjigjet pyetjeve te thjeshta "cfare"
- Kundershton duke thene "jo" me koke
- Thote disa kafshe / apo ben tingujt e tyre
- Thote 10-50 fjale afer 18 muajshit
- Tregon me gisht objektet



ZHVILLIMI GJUHESOR

18-24 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- Ndjek komandat hapësinore "vere ne kuti"
- I kthen përgjigje pyetjeve me po/jo
- Kupton foljet (ha, pi, fleme, ikim)
- Ndjek komandat e thena pa gjeste
- Degjon histori të thjeshta gjatë kohës së leximit
- Tregon objektet kur i thua emrin
- Imiton sjelljet/gjestet e të tjerëve.

GJUHA E SHPREHUR

- Thotë nga 10 fjale (18 muajsh) deri në 300 fjale (24 muajsh)
- Fillon të kombinojë dy fjale
- Thotë emrin e objekteve që njeh mirë
- Thotë emrin e tij
- Pyet "çfarë është kjo..."
- Imiton me shpesh fjale dhe me qarte
- Fillon të ketë përgjigje pyetjeve të thjeshta



ZHVILLIMI GJUHESOR

24-30 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- Degjon nje histori 5 minuta
- Zbaton komanda dyshe "merre topin dhe vere te kutia"
- Identifikoin veprime ne figura "djali po gjuan topin"
- Kupton peremrat "ti, une"
- Kupton fjalet e sasise "shume, pak, te gjitha"
- Tregon lehtesisht me gisht objektet ne nje liber kur permenden

GJUHA E SHPREHUR

- Perdor nga 50 fjale (minimumi 24 muajsh) deri ne 500 fjale mesatarisht (30 muajsh).
- Fillon te perdore formen e shumesit
- Perdor folje
- Perdor "i imi" apo "une"
- Ben kombinime 2-3 fjale bashke
- Pergjigjet ndaj "cfare dhe ku?"
- Fillon te pyese "cfare, ku?" o ask what/where ?'s



ZHVILLIMI GJUHESOR

30-36 MUAJ

GJUHA E KUPTUAR

- Degjon nje histori 10-15 min
- Ndjek komanda me 203 hapa
- Kupton mbiemra si "e madhe/ vogel"
- Kupton shume peremra
- Tregon 10 objekte nese i pershkruan nga funksioni "me trego ate gje qe mund ta hame"

GJUHA E SHPREHUR

- Perdor nga 250 deri ne 1000 fjale (afer 36 muajshit)
- Perdor kohen e shkuar
- Perdor peremra te ndryshem
- Kombinon 3 fjale +
- Pergjigjet pyetjeve "cfare ku.." gjate gjithe kohes
- Ben pyetje "cfare ku" gjate gjithe kohes
- I shpreh emocionet ne forme verbale
- U thote emrat shumices se gjerave dhe njerezve te njohur
- Mund te beje bisede bazike



Perfundim

DISA KESHILLA NGA UNE PERSONALISHT

Guret kilometrik jane orientim fantastik per prinderit per te ndjekur zhvillimin e femijes dhe jane te dizenuar per te qene ndihme dhe suport, jo e kunderta! Gjithmone fokusohuni te zhvillimi ne teresi i femijes, dhe jo te nje element specifik apo ta izoloni nje aftesi te caktuar, sepse zhvillimi i femijes ne tre vjecarin e pare eshte shume holistic (i plote) dhe duhet pare si i tille.

Per moshen e vogel sidomos 12-18 muajsh ndersa femija fillon te flase fjale e para, kini parasysh qe edhe grupe tingujsh qe perdoren gjithmone per te njejten fjale/objekt konsiderohet si fjale keshtu nese femija thote "muuu" sa here sheh lopen, ajo eshte nje fjale per te. Nese efmija juaj e ka kaluar nje moshe te cakuatr por nuk ka plotesuar nje pjese te madhe te gureve, dhe jeni e shqetesuar nje keshille me mjekun pediater se pari do ju vlente shume! Shpresoj t'ju kete ardhur sadopak ne ndihme!

Perqafime *Ina*

P.S per me shume informacione mbi zhvillimin e femijes, tips, ide lojrash dhe aktivitetesh e jo vetem mos harroni te beni follow [themom_corner.al](https://www.themom_corner.al) dhe [noahs.ark.al](https://www.noahs.ark.al)

